

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tillë si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkontinentale e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Inxhinier Mekanik per sistemet HVAC

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Inxhinieri Mekanik eshte perjeqjes per ndertimin e projekteve mekanike (kryesisht HVAC), apo per zberthimin, ose certifikimin e atyre qe behen nga te trete.

❖ DETYRAT KRYESORE

- Supervizim i instalimeve mekanike qe kryhen nga nenkontraktore.
- Zbatim i instalimeve mekanike qe do te kryhen nga stafi i kantierit (kryesisht HVAC, Aspirime dhe Ventilime).
- Monitorim i ecurise se punes, cilesise, kostove, proceseve te instalimit dhe hartim i dokumentacionit perkates (libreza masash, situacione, procesverbale, ditar punimesh).
- Koordinim me disiplinat e tjera per nevojat qe kane sistemet mekanike per tu montuar, vene ne pune dhe kryer sherbime.
- Organizim dhe monitorim i grupeve instalatore.
- Hartim i listave te detajuara te materjaleve qe cohen per prokurim ose per prodhim. Monitorim, kontroll dhe verifikim i porosise sipas kerkeses.
- Identifikim ne kohe te ndryshimeve eventuale te cilat kerkonte pershatje te projekteve.
- Ndjekje e procedurave per kontrollin, verifikimin dhe marrjen ne dorezim te instalimeve mekanike.

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Fakulteti i Inxhinierise Mekanike, Energjitike

Gjuhe te huaja: Anglisht, Italisht

Njohuri kompjuterike: Msc Office, Autocad, Microsoft Project,

Eksperiencia e kerkuar: Min 3 vjet experience ne zbatim. Te jete i gatshem te punoje jashte Tirane dhe/ose jashte vendit.

Te gjithe te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin "apliko online".

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 30 Maj 2022**, ora 17:00.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi "Mbrojtjen e të dhënavë personale".